

VENDIM
Nr.435, datë 25.6.2004

PËR KRITERET DHE MASËN E KOMPENSIMIT TË USHTARAKUT TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, KUR EMËROHET OSE
KOMANDOHEM NË DETYRË JASHTË VENDBANIMIT TË TIJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 25 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ushtarakut të Forcave të Armatosura, që, për nevoja shërbimi, emërohet me detyrë jashtë vendbanimit të tij të përhershëm dhe, në të njëjtën kohë, transferon edhe familjen, Ministria e Mbrojtjes i siguron transportin falas të familjes dhe të orendive shtëpiake, me mjetet e saj.

2. Ushtarakut arkiv të Forcave të Armatosura, që komandohet në një detyrë tjetër, jashtë vendbanimit të tij të përhershëm, dhe nuk i sigurohet transporti i përditshëm, i sigurohet fjetja në shtëpitë e ushtarakëve.

Shpenzimet e fjetjes të përballohen në masën 100 për qind nga struktura, ku ai është i komanduar.

3. Në rastet kur nuk mund t'i sigurohet fjetja në këto mjedise, ushtaraku përfiton një kompensim për fjetje, për ditët efektive të punës, të cilat paguhen sipas dokumenteve të paraqitura, por jo më tepër se 2000 (dy mijë) lekë për çdo natë.

4. Për vajtjen dhe kthimin nga familja, ushtarakut të komanduar i paguhen shpenzimet e udhëtimit, për një herë në javë, sipas dokumenteve të paraqitura, por në vlerë jo më të madhe se çmimet e miratuara për linjën përkatëse të autobusit.

5. Në rastet e fatkeqësive të personave në ngarkim të tij, ushtarakut i mundësohet udhëtimi për në familje, me mjetet e njësive apo të repartit ku është i komanduar ose i kompensohet vlera e udhëtimit.

6. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes të nxjerrë udhëzimin përkatës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano